



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E KULTURËS  
ZYRA E KOORDINIMIT DHE ADMINISTRIMIT  
TE PARQEVE ARKEOLOGJIKE APOLONI DHE BYLIS**

**FORMULARI I PËRSHKRIMIT TË PUNËS**

I

**TË DHËNAT PËR POZICIONIN E PUNËS**

Emërtesa e pozicionit: *Përgjegjës Sektori Bylis*

Institucioni: Zyra e Administrimit dhe Koordinimit të Parqeve Arkeologjike Apoloni dhe Bylis.

Drejtoria: Zyra e Administrimit dhe Koordinimit të Parqeve Arkeologjike Apoloni dhe Bylis.

Spektori: Parku Arkeologjik Bylis

Raporton tek: *Titullari i institucionit ZAKPA AB*

II

**MISIONI**

*(Një deklaram i përmbledhur që shpreh thelbin e qëllimit për të cilin ekziston Institucioni/Drejtoria/Spektori)*

Spektori i Bylisit ka si qëllim mbrojtjen, dokumentimi, mirëmbajtjen dhe menaxhimin e sitit sipas ligjit të 27/2018 " Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzet" dhe planit të punës të dhënë nga titullari ose institucionet e varësisë, të Ministrisë së varësisë apo bashkëpunuese.

III

**QËLLIMI I PËRGJITHSHËM I POZICIONIT TË PUNËS**

*(Mbajtësi i këtij pozicioni (personi identifikohet me emërtesën e pozicionit) përgjigjet tek (marrëdhënia e varësisë) për (jepen përgjegjësitë e veçanta funksionale).*

*Përgjegjësi i Sektorit Bylis përgjigjet tek Titullari i institucionit për menaxhimin e çështjeve që lidhen me Sektorin e Parkut Arkeologjik Bylis në ZAKPA Apoloni dhe Bylis ku përfshihen monitorimi (surveji) dhe mbrojtja, raportimi dhe ndërhyrja në monumente, rilevimet e monumenteve dhe kartelizimi, pezullimi i ndërhyrjeve në park, trajnimi i të rinjve, gërmimi arkeologjik dhe dokumentimi, kontrolli/ raportimi i biletarisë etj.*

IV

**DETYRAT KRYESORE**

*(Detyrat kryesore paraqiten si rezultat i punës së kryer)*

a. Pjesëmarrja në gërmime/survei arkeologjike dhe punët restauruese duke raportuar ecurin e punimeve dhe dokumentimin e tyre.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

- b. Mbikqyrje dhe raportime të sitit të Bylisit për mbrojtje të monumenteve/ territorit dhe bashkëpunimeve ndërsektorial dhe ndërinstytucional.
- c. Dokumentimin dhe kartelizimin e monumenteve dhe objekteve arkeologjike.
- ç. Organizimin e punëve të mirëmbajtjes dhe koordinimin me planin e dhënë nga titullari apo institucionet e varësisë të Ministrisë së varësisë dhe ato bashkëpunuese.
- d. Kontrolli dhe koordinimi i biletarisë me Sektorin e Financës sipas direktivave të eprorit direkt.

V.

#### **MBIKQYRJA**

Drejtim i përgjithshëm nga Drejtori dhe drejtim i posaçëm nga delegimi i titullarit tek Përgjegjësi i Sektorit të Arkeologjisë dhe Menaxhimit të Trashëgimisë Kulturore, lidhur me menaxhimin e punëve dhe sitit të Bylisit.

VI.

#### **STAFI NËN VARËSI (nëse ka)**

Tre (3 ) punëtor mirëmbajtje.

VII

#### **KËRKESAT E POSAÇME**

(arsim/përvoja në punë /të tjera për kategorinë/klasën /grupin)

Arsimi: Arsim i Lartë Master Histori/ Arkeologji/Trashëgimi Kulturore/Arkitekturë

Përvoja: dy (2) deri në pesë (5) vjet minimalisht në sektoret e administratës publike/ trashëgimisë kulturore/ parqe arkeologjike apo misionet arkeologjike/restauruese/ dokumentuese.

Tjetër: Kategoria IV-a, kategori dhe pozicion sipas Kodit të Punës.

Afati i dorëzimit të dokumentave pranë ZAKPA AB 13 janar 2023

VIII

#### **NËNSHKRIMI**

Nëpunësi :.....Firma:

Eprori direkt:.....Firma:

Titullari i Institucionit ZAKPA Apoloni dhe Bylis: ORNELA DURMISHAJ Firma: